

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit M. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja të shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2855/2015 të datës 12.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat B. K., me date 12.01.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

### AKT GJYKIM

#### I akuzuari:

M. B., nga i ati M., dhe nëna V. e lindur L., i lindur me datë , në Prizren, ku edhe jeton, në rrugën , nr. , ka të kryer shkollën e mesme, momentalisht i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Prej datës së pavërtetuar e deri me datë 10.06.2015 i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e shfrytëzon energjinë elektrike në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehsor nr. , i cili në brendi për rreth qelqit nga ana djathtë është futur shiriti filmik është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me çka të dëmtuarës KEDS Kompania Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a Distrikti Prizren, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 1.265,42 Euro,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja të shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.


Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 320 të KP-ës, të akuzuarit ia shqipton:

### DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

### DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të



ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg.

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.


### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2855/2015 të datës 12.11.2015, kundër të akuzuarit M. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja të shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Musli Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: gjatë shqyrtimit gjyqësor u dëshmuar në mënyrë të plotë dhe të tërësishme se gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës PP.nr.2855/2015 të datës 12.11.2015, ndaj këtu të pandehurit M. B., është e konstatuar drejt, dhe se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën e ngarkon aktakuza. Kjo ka rezultuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, A. M. si dhe A. S. si dhe të ekspertit të elektro energjetikës M. G., andaj propozoj gjykatës që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënimin sipas ligjit, po ashtu prokurori i shtetit i propozon gjyqtarit gjykues që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e po ashtu edhe ato rënduese nëse gjen të cilat ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prizren, B. P. në fjalën përfundimtare deklaron, e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, e po ashtu si palë e dëmtuar parashtror kërkesë pronësore juridike në shumë të dëmit të shkaktuar prej 1.265,42 euro,

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat B. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që në fillim të shqyrtimit gjyqësor edhe tani në fjalën përfundimtare edhe një herë e përsërisë që aktakuza e prokurorisë themelore në Prizren, e parashtruar kundër të mbrojturit tim, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, është e pa bazuar, këtë e them që në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të çartë asnjë nga elementet qenësore të kësaj vepre penale, të kryera nga ana e të mbrojturit tim. Provat e administruara nga ana e gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe ato deklaratat e dëshmitarëve A. M. dhe A. S., fillimisht janë kontradiktore në mes vete, të pa kuptimta dhe të pa qarta, ngase në procesverbalin mbi ndërrimin e njehsorit theksohet që dyshohet që pluhuri në njehsorin e të mbrojturit tim gjendet në anën e majtë të njehsorit, ndërsa dëshmitari zyrtari i qendrës së kalibrimit thekson që pluhuri tek njehsori i konsumatorit është në anën e djathtë, e po ashtu edhe sipas mendimit të ekspertit të elektro teknikës M. G., i cili në mënyrë të qartë në ekspertizën e vet e ka përshkruar gjendjen e njehsorit, në fund konstaton që nuk është vërtetuar që i mbrojturi tim të ketë futur shiritin filmik për ta ndërprerë punën e njehsorit, dhe se një konstatim i tillë i cekur disa herë gjatë shqyrtimit gjyqësor është



vetëm një supozim, andaj të gjitha këto të cekura na sjellin pranë konstatimit që në veprimet e të mbrojturit tim nuk ka elemente të veprës penale e cila i vihet në barë, andaj nga të cekurat i propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të marr aktgjykim lirues, por në rast se gjykata edhe për kundër të gjitha të cekurave më lart gjen që në veprimet e të mbrojturit tim ka elemente të veprës penale, atëherë i propozoj që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, të ketë parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese në favor të mbrojturi tim dhe ate sjelljen korrekte të njëjtit, kemi të bëjmë me një person familjar, baba i tre fëmijëve, është person familjar, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin e tij që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla, të gjitha këto elemente dhe rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.


I akuzuari M . B , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: në tërësi e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, edhe një herë në fund i propozoj gjykatës që duke pasur parasysh të cekurat më lart të mbrojtësit tim, gjykata të marr aktgjykim, me të cilin do të më liroj nga kjo akuzë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Prej datës së pavërtetuar e deri me datë 10.06.2015 i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e shfrytëzon energjinë elektrike në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehsor nr. , i cili në brendi për rreth qelqit nga ana djathtë është futur shiriti filmik është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me çka të dëmtuarës KEDS Kompania Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a Distrikti Prizren, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 1.265,42 Euro,

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave dhe ate deklaratave të akuzuarit, dëshmitarëve A. S. , zyrtarë pranë Qendrës së kalibrimit në Prishtinë. A . M : zyrtarë pranë të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prizren, ekspertit M . G. , dhe provave materiale dhe ate procesverbali – raporti me numër të datës 10.06.2015, procesverbali i qendrës së kalibrimit në Prishtinë me numër të datës 15.06.2015. fatura me numër të datës 17.06.2015. raporti i kalkulimit me numër dhe me numër të ID të rastit në emër të këtu të akuzuarit, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim që i akuzuari prej datës së pavërtetuar e deri me datë 10.06.2015 me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e shfrytëzon energjinë elektrike, dhe këtë e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetë dijshëm për veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj, po ashtu në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë e ka vërtetuar edhe përgjegjësinë e tij penalno juridike, nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëshmitarit A . S. , zyrtarë pranë Qendrës së kalibrimit në Prishtinë, i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 31.10.2016 deklaron me procesverbalin e datës 16.06.2015, kemi përpiluar procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit me numër si anëtari i komisionit kemi gjetur që njehsori elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, në brendin e njehsorit komisioni ka vërejt se për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik, me të



cilin shirit filmik është penguar puna e diskut, në brenditë e të njehsorit ka pluhur në shiritin filmik, prandaj qëndroj në tërësi pranë të cekurave si në procesverbal edhe sot në shqyrtimin gjyqësor.

Shiriti filmik është futur në anën e djathtë për rreth qelqit, që vërtetohet në foto e parë majtas, nga nëntë foto që janë të bashkangjitura procesverbalit, shiriti filmik është futur në anën e djathtë të qelqit, më konkretisht në njehsorin që gjendet në faqen e 2, në anën e djathtë të qelqit të njehsorit është futur shiriti filmik, gjatë punës të njehsorit shiriti filmik e ka penguar, ngadalësuar apo bllokuar punën e diskut që ta regjistroj energjinë elektrike të shpenzuar, po me pengimin e punës së diskut, nuk është regjistruar energjia elektrike e shpenzuar në mënyrë të drejtë, dhe me këtë nënkuptohet që është kryer vepra penale vjedhja e shërbimeve komunale, ngase energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, për shkak të pengimit të punës së diskut.

Në momentin e hapjes së njehsorit në qendrën tonë të kalibrimit jemi prezent tre anëtarët e komisionit, si dhe udhëheqësi e qendrës së kalibrimit, nuk është e obliguar që gjatë ekzaminimit të njehsorit ta njoftojmë edhe konsumatorin. Njehsorët i identifikojmë vetëm na bazë të numrit të njehsorit, nuk kemi kurrfarë emri apo mbiemri apo ndonjë gjeneralë tjetër të konsumatorit.

Shiriti filmik që është futur në njehsor, gjegjësisht pluhuri i shiritit filmik, është fakt që ne nuk kemi gjetur konkretisht shiritin filmik, por pluhuri i shiritit filmik ka ekzistuar brenda në njehsor, e po ashtu është vërejtur edhe vendi që ka lënë gjurmë futja e shiritit filmik dhe ate si theksova më lart në anën e djathtë të njehsorit për rreth qelqit. Nuk e di kush e ka futur shiritin filmik. Në momentin e ekspertimit të njehsorit nuk ka qenë prezent zyrtari i MTI. Për të konstatuar që ka pasur pluhur kjo vërehet me sy të lirë, njehsorët janë zakonisht hermetikisht të mbyllur, nuk mund të depërtoj as uji, në rastin konkret pluhurin e shiritit filmik e kemi vërejtur në bazë të dëmtimit për rreth qelqit, për të konstatuar që është pluhur i shiritit filmik shihet me sy të lirë, të njëjtën e vërtetojmë me rastin e shikimit me anë të llupës – zmadhuesit, e po ashtu mund të vërehen edhe grimca të shiritit, pluhuri i shiritit filmik dallohet nga pluhuri natyror.

Unë mund të flasë lidhur me procesin tonë, kur është hapur në ekzaminim në qendrën të kalibrimit është vërejtur pluhuri në anën e djathtë, e sa i përket procesverbalit të përpiluar në vend të ngjarjes, lidhur me ate unë nuk mund të deklarojem. Nuk mund të di kohëzgjatjen e qëndrimit të shiritit filmik në njehsor.

Nuk mund të deklarojem lidhur me ate se në bazë të cilës provë – fakt ka mundur të konstatohet shuma e humbjeve të konstatuara në shumën prej 1.265,42 Euro,

Për brendësit të njehsorëve dhe rregullsitë si dhe pa rregullsitë në të njëjtat fjala e fundit është e Qendrës së kalibrimit, ndërsa sa i përket anës së jashtme janë ekipet në teren. Shqyrtimin sa i përket saktësisë e njehsorit e bënë Qendra e kalibrimit, nëse kërkohet nga Distrikti cilit regjion i përket pala, por në rastin konkret nuk mund të sqarohem për vlerësimin e saktësisë të njehsorit, ngase nuk kam fletë shqyrtim në të cilën fazë vlerësohet saktësia.



Dëshmitari A. M., zyrtar pranë të dëmtuarës KEDS – Distrikti në Prizren, në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.12.2016, deklaroi: Me datë 10.06.2015, kam qenë në cilësinë e zyrtarit të KEDS-it, për ndërrimin e njehësorit të konsumatorit këtu të akuzuarit, kam qenë unë dhe kolegu Muharrem G. Ne punojmë dhe veprojmë me urdhëresë të KEDS-it, gjegjësisht të departamentit të shërbimit për kontrollim. Në rastin konkret nuk më kujtohet, ngase ne zakonisht gjetë punës tonë kemi ekzekutime të urdhëresave të ndryshme dhe me rastin e kontrollimit të njehësorve, në secilin njehësor që dyshojmë për ndonjë keqëpërdorim të të njëjtit, të njëjtin e ndërrojmë dhe të njëjtin e dërgojmë në qendrën e kalibrimit në Prishtinë, i cili departament me ekspertizën e vet e konstaton gjendjen e njehësorit. Me të vërtetë nuk më kujtohet si kemi vepruar me rastin e ndërrimit të njehësorit të këtu të akuzuarit. Në procesverbalin e nënshkruar nga ana ime me numër 1489682, konstatimin që dyshohet që në anën e majtë ka pluhur, ky ka qenë vetëm një konstatim që ne e kemi gjetur gjegjësisht kemi dyshuar, të njëjtin njehësor sipas procedurave tona të brendshme e kemi dërguar në qendrën e kalibrimit e cila qendër është kompetente për vlerësimin e gjendjes të njehësorit. Ne shënojmë të gjeturat në bend të ngjarjes, sa i përket dyshimit tonë që ka qenë në anën e majtë, atë e kemi konstatuar në anën nga drejtimi ynë. Theksoj që në çdo dyshim që kemi e heqim njehësorin, në rastin konkret, a e kemi parë apo nuk e kemi parë pluhurin nuk më kujtohet. Ne nuk e kemi gjetur shiritin në njehësor për momentin, ngase a ka pasur apo nuk ka pasur shirit filmik këtë e konstaton qendra e kalibrimit. Nuk më kujtohet a ka qenë njehësori i ri apo i vjetër. Nuk e di si është konstatuar shuma e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 1.265, 42 Euro. Nuk e di kush e bënë saktësinë e njehësorit, se a ka pas ndërhyrje apo jo në të njëjtin. Nuk më kujtohet se a kemi shkuar te i akuzuari për ta ndërruar njehësorin apo për të vërejtur a është i njëjti në rregullë. Ne si zyrtar së pari e kontrollojmë njehësorin si theksova më lart, dhe në rast të gjetjes së ndonjë parregullësie të njëjtin e ndërrojmë dhe njehësorin e hequr e dërgojmë në kalibrim. Mund të shihet edhe me sy të lirë se a ka pluhur mbrenda njehësorit. Ne vetëm kemi dyshuar që ka pluhur, ashtu siç kemi theksuar në procesverbal. Kemi dyshuar në bazë të shikimit të drejtëpërdrejt, andaj nga ky dyshim edhe e kemi hequr të njëjtin gjegjësisht e kemi ndërruar.

Eksperti Muharrem G. në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.01.2017, deklaroi: me datën 26.12.2015, me urdhëresë të gjykatës sipas kërkesës së palëve kam përpiluar ekspertizën lidhur me njehsorin e konsumatorit Muharrem G. Në bazë të dokumentacionit që kam poseduar lidhur me këtë ekspertizë dhe ate procesverbaleve të datës 10.06.2015 dhe 16.06.2015, të përpiluara nga ana e zyrtarëve të dëmtuarës, lidhur me njehsorin me numër 1489682, është konstatuar pas nderimit të njehsorit të cekur, pasi që i njëjti ka qenë njehsor mekanik, është bërë ndërrimi i njehsorit në ate elektronik, dhe njehsori i demontuar është dërguar në laboratorium, ku pas hapjes të pjesës së sipërme të njëjtit është konstatuar që në brendësi i njëjti ka pluhur dhe se rrethoja e xhamit të njehsorit të cekur është paksa i lakuar. Nga kjo të njëjtit kanë konstatuar që është bërë ndërhyrje në njehsor, por nuk është vërtetuar që i akuzuari të ketë ndërhyrë në mënyrë të drejtë për drejt në njehsor, pra në momentin kur i njëjti ka vepruar për të kryer veprën e cila është konstatuar nga ana e qendrës së kalibrimit.

Duke pasur parasysh që njehsori i konsumatorit është i prodhimit të viteve 1970, e po ashtu faktin që është bërë leximi manual i njehsorit për energjinë e shpenzuar nga ana e zyrtarëve të dëmtuarës sipas detyrës zyrtare, e nuk është vërejtur një e gjetur e tillë si në kalibrim, mund të konstatoj edhe në bazë të faturës të rikthimit e humbjeve që këtu konsumatori nuk e ka keq



përdorur shfrytëzimin e energjisë elektrike në kohën dhe periudhën e cila i vihet në barë. Tërë këto të gjetura i kam përshkruar në mënyrë detale edhe në ekspertizën me shkrim.


Po qëndroj pranë konstatimit si në ekspertizën me shkrim dhe atë në pikën 8 të konstatimit që në bazë të nenit 3 të procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike çdo dëmtim fizik i shtëpizës, xhamit të njehsorit trajtohet si shfrytëzim i pa autorizuar i energjisë elektrike, qëndroj pranë konstatimit si në fund të ekspertizës që konsumatori është përgjegjës për posedim të njehsorit të dëmtuar, Në faqen e fundit, dhe në pasusin e fundit të ekspertizës theksoj që njehsori është mjaftë i vjetër, viti i prodhimit 1973 dhe është dashtë që shumë më herët të bëhet zëvendësimi ose të silltet në bazhdarim ky njehsor i cili nuk i përmbush kushtet për përdorim sipas kushteve të përcaktuara nga MTI-ja, këtë e bazoi nga fakti që njehsori është i vitit 1973, andaj për vërtetimin dhe kontrollimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar duhet të bëhet bazhdarimi, që nën kupton kontrollimin e saktësisë të matjes të energjisë elektrike të shpenzuar, a është në zonën e lejuar të saktësisë që nënkupton shqyrtimin e saktësisë të matjes.

Sa i përket futjes të shiritit në njehsor, sipas të gjeturave të qendrës së kalibrimit, një konstatim i tillë nga të njëjtit është supozim. Këtë e konstatoi në bazë të faktit që nuk është hasur shiriti filmik, por me rastin e ndërhyrjes në njehsor të shiritit filmik është krijuar hapësira në momentin e veprimtimit në njehsor dhe atë dëmtimit të xhamit të njehsorit, dhe në rastin e heqjes të shiritit filmik i njëjti nga ky fërkim të shiritit me xhamin e njehsorit ka shkaktuar një pluhur, i cili pluhur është hasur në brendi të njehsorit, ky është konstatim i Qendrës së kalibrimit, por decidivisht shiriti filmik nuk është hasur.

Në momentin e ndërrimit të njehsorit, njehsori ekzistues është marr nga ana e zyrtarëve të KEDS-it dhe atë në bazë të procesverbalit mbi ndërrimin e njehsorit që nën kupton që të njëjtit i është vendosur njehsori i ri. Njehsori i vjetër, është dërguar në Qendër të kalibrimit, ku i njëjti është hapur, dhe pas hapjes është gjetur te i njëjti pluhuri, dhe të gjeturat të evidentuara në procesverbalin mbi kalibrimit. Asnjë njehsor nuk mund të konstatohet të ketë pasur ndërhyrje, pa u hapur, ngase ndërhyrje në njehsor konstatohen vetëm në momentin e hapjes, në rastin konkret njehsori pasi që është dërguar në kalibrim është konstatuar gjendja e gjetur në bazë të procesverbalit mbi kalibrimit.

Me rastin e përpilimit të ekspertizës nuk kam pasur qasje në njehsorin e konsumatorit. xhami i njehsorëve mekanik është i mbyllur në mënyrë hermetike nga ana e brendshme njehsorit, e rrethuar me kornizë e cila përbën një hidro izolim , që nënkupton mbrojtjen e të njëjtin për hyrje të ujit apo ndonjë substancë tjetër, p.sh. pluhurit e të ngjashme, nuk ka mundësi që as pluhuri e as një lloj substance tjetër e ngjashme të haset apo të gjetet në njehsor pa një ndërhyrje. Nuk e kam bërë kalkulimin e energjisë elektrike të shpenzuar të konsumatorit në bazë të raportit mbi ndërrimin e njehsorit të datës 10.06.2015, me rastin e përpilimit të ekspertizës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.01.2017, është bërë leximi i shkresave dhe atë: procesverbali – raporti me numër 07/15 të datës 10.06.2015, procesverbali i qendrës së kalibrimit në Prishtinë me numër 08/15 të datës 15.06.2015. fatura me numër 07/15 të datës 17.06.2015. raporti i kalkulimit me numër 07/15 dhe me numër të ID të rastit 07/15 emër të këtu të akuzuarit,




I akuzuari M. Hoxha, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: në ditën kritike kur kanë qenë zyrtarët e të dëmtuarës në shtëpinë time për ta ndërruar njehsorin, nuk kam qenë personalisht. Me rastin e ndërrimit të njehsorit me datën 10.06.2015, ka qenë prezent vetëm bashkëshortja. Kanë sqaruar që e bëjnë nderimin e njehsorit, i cili sipas tyre ka qenë në rregull, kanë përpiluar procesverbal, e kanë marr njehsorin e vjetër, e kanë vendosur njehsorin e ri, ndërsa njehsorin e vjetër e kanë dërguar në kalibrim, dhe diku pas tre muajve në faturën mujore që kam pranuar për shpenzimin e energjisë elektrike kam vërejtur një shumë prej 1.265,42 Euro, dhe kam shkuar në zyret e të dëmtuarës për të kërkuar sqarim për këtë shumë të madhe, të njëjtit më kanë udhëzuar në të drejtën e ankesës tek organet kompetente, për çka pas harxhimit të mjeteve të brendshme në kuadër të dëmtuarës, kam paraqitur edhe padinë pranë kësaj gjykate kundër të dëmtuarës për vërtetimin e anulimit të kinse borxhit tim ndaj të dëmtuarës, procedurë kjo që është në zhvillim e sipër. Jo unë as në kohën e luftës, e as deri në vitin 2015 nuk e kam ndërruar asnjëherë paraprakisht njehsorin, as që më ka shkuar mendja që ta ndrojë ndonjëherë. Gjatë luftës të fundit në Kosovë, pas braktisjes së shtëpisë nga ana jonë familjare, në të njëjtën janë vendosur në atë periudhë afro tre muaj paramilitarët serb dhe ekzistonte mundësia që të njëjtit të kenë ndërhyrë atëherë në njehsorin tim, pasi që kur jemi kthyer në shtëpinë tonë e njëjta ka qenë plotësisht dhe tërësisht e dëmtuar dhe e shkaktuar. Jam para paguesi i rregullt i energjisë elektrike, dhe asnjëherë nuk kam pasur borxh ndaj të dëmtuarës. Unë personalisht dhe anëtarët e familjes sime e as ndonjë person tjetër nuk e di dhe nuk e kam parë që të kenë ndërhyrë në njehsor.

Me rastin e ndërrimit të njehsorit nga ana e zyrtarëve të dëmtuarës, e di që në kohën dhe orën e cekur kam qenë në dyqanin tim. Më është lënë një kopje e raportit – procesit mbi ndërrimin e njehsorit. Kam paraqitur ankesë pranë të dëmtuarës e cila ankesë është shqyrtuar nga ana e zyrës së rregullatorit të energjisë elektrike pranë të dëmtuarës, dhe pas refuzimit të ankesës më kanë udhëzuar në gjykatë për kontestim të këtij borxhi dhe si theksova më lart procedura lidhur me këtë është në zhvillim e sipër. Unë është e vërtetë që kur më është ndërruar njehsori nuk kam kërkuar sqarim tek e dëmtuara, sqarimin e kam kërkuar pasi që më ka ardhur fatura mujore me dëmin e shkaktuar të dëmtuarës, atëherë me të kuptuar i jam drejtuar të dëmtuarës me ankesë, e pas kësaj siç theksova më është refuzuar ankesa lidhur me borxhin ndaj të dëmtuarës, dhe tani pres përfundimin e kësaj çështjeje në gjykatë. Të gjitha janë elemente dhe pajisje që i posedon çdo amvisëri janë të evidentuar në procesin mbi ndërrimin e njehsorit,

Në fund theksoj që unë nuk e kam ditur që ndërrimi i njehsorit, të jetë si detyre imja që ti drejtohem të dëmtuarës, aq më shumë që unë e kam ndier veten të pastër sa i përket pagesës të energjisë elektrike të dëmtuarës, e aq më pak të më ketë shkuar mendja që njehsori im mund të jetë i dëmtuar. Kjo ka qenë edhe arsyeja që unë nuk jam drejtuar të dëmtuarës me rastin e ndërrimit të njehsorit.

Nga provat e administruara dhe të cekurat më lart gjykata në tërësi vërtetoi gjendjen faktike dhe atë të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KP-ës, në bazë të deklaratës të zyrtarit të qendrës së kalibrimit në Prishtinë dëshmitarit A. S. S., zyrtarë pranë Qendrës së kalibrimit në Prishtinë, si anëtari i komisionit kemi gjetur që njehsori elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, në brendin e njehsorit komisioni ka vërejt se për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik, me të cilin shirit filmik është penguar puna e diskut, në brenditë e të njehsorit ka pluhur në shiritin



filmik, deklaratë e cila në tërësi përputhet edhe me deklaratën e dëshmitarit A M. i cili në tërësi qëndron pranë procesverbalit të nënshkruar nga ana e tij me numër 01/15, dhe konstatimin që dyshohet që në anën e majtë ka pluhur, ky ka qenë vetëm një konstatim që i njëjti së bashku me kolegun e tij Sh. G., e kemi gjetur gjegjësisht kemi dyshuar, të njëjtin njehësor sipas procedurave të brendshme e dëmtuara e ka dërguar në qendrën e kalibrimit e cila qëndër është kompetente për vlerësimin e gjendjes të njehësorit, e poashtu edhe deklarata e ekspertit të energjetikës M. G., i cili në mënyrë profesionale konstaton se çdo dëmtim fizik i shtëpizës, xhamit të njehësorit trajtohet si shfrytëzim i pa autorizuar i energjisë elektrike dhe që konsumatori është përgjegjës për posedim të njehësorit të dëmtuar, por me rastin e ndërhyrjes në njehësor të shiritit filmik është krijuar hapësira në momentin e veprimit në njehësor dhe ate dëmtimit të xhamit të njehësorit, dhe në rastin e heqjes të shiritit filmik i njëjti nga ky fërkim të shiritit me xhamin e njehësorit ka shkaktuar një pluhur, i cili pluhur është hasur në brendi të njehësorit, ky është konstatim i Qendrës së kalibrimit, por decidivisht shiriti filmik nuk është hasur, xhami i njehësorëve mekanik është i mbyllur në mënyrë hermetike nga ana e brendshme njehësorit, e rrethuar me kornizë e cila përbën një hidro izolim, që nënkupton mbrojtjen e të njëjtin për hyrje të ujit apo ndonjë substancë tjetër, p.sh. pluhurit e të ngjashme, nuk ka mundësi që as pluhuri e as një lloj substance tjetër e ngjashme të haset apo të gjetet në njehësor pa një ndërhyrje. Deklaratat e cekura më lartë në tërsinë e tyre janë identike të cilat së bashku në mënyrë të bazuar dhe të plotë vërtetojnë veprimet inkriminuese të akuzuarit e gjendja e lartëcekur faktike është në përputhje të plotë edhe me provat materiale të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ate procesverbalit – raporti me numër 0175498 të datës 10.06.2015, procesverbalit i qendrës së kalibrimit në Prishtinë me numër 08/15 të datës 15.06.2015. fatura me numër 01/15 të datës 17.06.2015. raporti i kalkulimit me numër 01/15 dhe me numër të ID të rastit 01/15 në emër të këtu të akuzuarit dhe pas administrimit dhe vlerësimit të njëjtave secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjykata erdhi në përfundim që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të cilat si tërësi e këtyre elementeve formohet edhe figura e veprës penale e cila i vihet në barë të akuzuarit, dhe me këtë rast gjykata konstaton që i akuzuari e ka dashur kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barë, ngase ka qenë i vetë dijjshëm që me veprimet e tij do të shkaktojë pasojën e ndaluar dhe ate duke shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar, ndërsa deklaratën të dhënë në mbrojtjen e vet të akuzuarit si dhe fjala përfundimtare e tij se kinse i njëjti nuk e ka ditur dhe nuk e ka prekur njehësorin, me të cilat veprime të njëjtin e ka dëmtuar duke ndërhyrë, dhe në këtë mënyrë të ketë shkaktuar pasojën e ndaluar, dhe se në mënyrë të rregullt e bënë pagesën e energjisë elektrike të shpenzuar dhe se ai personalisht e as anëtarët e familjes së tij nuk kanë ndërhyrë në njehësor e as të ketë vërejtur dikend që ka ndërhyrë në njehësorin e tij, kjo deklaratë sipas gjykatës konsiston vetëm me qëllim që të shkaktoj shmangie dhe përjashtim nga përgjegjësia penale për veprimet e kryera dhe lirim të tij nga aktakuza. Nga të cekurat gjykata ka ardhur në përfundim që në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënimin në bazë të ligjit duke e vërtetuar paraprakisht përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese që si rrethanë lehtësuese është marrë, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese





rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, gjendjen shëndetësore të tij, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i dy fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësive së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.


Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1884/2015 me datë 12.01.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.